REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 qershor 2018
Nr. ref.: RK 1276/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI34/18

Parashtrues

Albert Berisha

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Albert Berisha nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 518/2016, të 4 majit 2017, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, PKR. nr. 263/15, të 29 prillit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore të lartpërmendura, me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), *"të vendosë masë të përkohshme, sepse konsideron se po privohet padrejtësisht nga liria, si rezultat i nxjerrjes së vendimeve gjyqësore kundërkushtetuese"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 27 [Masat e përkohshme], nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 54 [Kërkesa për masa të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 mars 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 9 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 13 mars 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 13 mars 2018, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja urdhëroi bashkimin e kërkesës së regjistruar me numër KI37/18, me kërkesën e parashtruesit të regjistruar me numër KI34/18.

10. Më 19 mars 2018, parashtruesi parashtroi një letër në Gjykatë duke kërkuar që mos ta bashkojë kërkesën e tij me kërkesën e regjistruar me numër KI37/18.

11. Më 22 mars 2018, në pajtim me rregullin 37 (3) të Rregullores së punës, Kryetarja urdhëroi ndarjen e kërkesës së parashtruesit të regjistruar me numër KI34/18 nga kërkesa e regjistruar me numrin KI37/18.

12. Më 17 maj 2018, parashtruesi parashtroi në Gjykatë argumente shtesë në mbështetje të kërkesës së tij.

13. Gjykata, në pajtim me rregullin 30 (3) (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit) të Rregullores së punës, nuk mori parasysh argumentet shtesë të paraqitura nga parashtruesi më 17 maj 2018.

14. Më 23 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 11 gusht 2014, Policia e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PK), e privoi parashtruesin e kërkesës nga liria për shkak të dyshimit të bazuar se kishte kryer veprën penale *"Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist"*, nga neni 143, paragrafi 2, të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

16. Më 26 gusht 2014, parashtruesi i kërkesës, në prani të mbrojtësit i cili i është caktuar sipas detyrës zyrtare, u mur në pyetje në polici. Parashtruesi i kërkesës dha deklaratën si në vijim: *"më 6 tetor 2013, jam nisur nga Prishtina në drejtim të Stambollit, e prej aty kam shkuar në Hataj, ku kam qëndruar një ditë e pastaj kam udhëtuar në qytetin Kilis, afër kufirit Turqi - Siri. Ndërsa, ditën e nesërme me ndihmën e një shtetasi turk, kam kaluar kufirin në mënyrë ilegale dhe kam shkuar në Siri, saktësisht në qytetin Tal Rivat, me ç' rast jam vendosur në një bazë në afërsi të Alepos, e pastaj më pyetën për arsyen e shkuarjes sime atje të cilëve iu kam thënë se kam ardhur për ta ndihmuar popullin sirian dhe nuk dua që të jem pjesë e Al Kaidës ..."*.

17. Më 7 maj 2015, Prokurori Special i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Prokurori) paraqiti në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), aktakuzën PPS. nr. 26/2015, kundër parashtruesit e kërkesës për kryerjen e veprës penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist", nga neni 143, paragrafi 2, të KPK-së.

18. Gjatë shqyrtimit në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës pohoi pafajësinë tij, duke deklaruar se: *"[...] qëllimi i shkuarjes se tij në Siri ka qenë për t'i ndihmuar popullit sirian kundër regjimit të Asadit dhe se nuk ka pasur qëllim që t'i bashkohet grupeve terroriste, më vetëdije të plotë ka marrë pjesë në grupin Ahra al Sham, i cili ishte një grup opozitar që nuk bënte pjesë në organizata terroriste, nuk ishte as në listën e zezë të Departamentit Amerikan të Shtetit"*.

19. Në fjalën përfundimtare në Gjykatën Themelore, mbrojtësi i parashtruesit deklaroi se: *"Prokurori special nuk arriti që të vërtetoj pretendimet e veta se i akuzuari Albert Berisha ka kryer veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPK-së"*.

20. Prokuroi në fjalën përfundimtare në Gjykatën Themelore tha *"[...] se disa nga të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, andaj për këta të akuzuar nuk është lëshuar në vlerësimin e provave por ka bërë vlerësimin e provave vetëm për të akuzuarit që nuk kanë pranuar fajësinë"*.

21. Më 29 prill 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin PKR. nr. 263/15, me të cilin parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale dhe ia shqiptoi dënimin me 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

22. Në arsyetimin e Aktgjykimit PKR. nr. 263/5 të Gjykatës Themelore theksohet se *"Gjykata nuk i fali besimin të akuzuarit Albert Berisha e as tezës mbrojtëse të avokates së tij, se kinse i akuzuari Albert nuk kishte qenë në dijeni për situatën në Siri, se ai atje kishte shkuar për t'ju ndihmuar popullsisë civile. [...] "Qëndrimi i të akuzuarit Albert Berisha, për një kohë të shkurtë në Siri nuk e liron nga përgjegjësia penale, deklarimet e tij në hetuesi dhe në shqyrtim kryesor janë kontradiktore.*
[...]
Gjatë matjes së dënimit për të akuzuarit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK-së".

23. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 263/15, duke deklaruar:

> *a) "ashtu që aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës, dhe se është dënuar në bazë të deklaratës së tij.*
>
> *b) Se në aktgjykime gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë,*
>
> *c) Se dënimi është i padrejtë, sepse ai është dënuar në mënyrë të padrejtë në bazë të fakteve që nuk janë vërtetuar"*.

24. Më 4 maj 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR. nr. 518/2016, me të cilin i refuzoi, si të pabazuara, pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës.

25. Në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 518/2016, theksohet:

> *a) "Sa i përket pretendimeve ankimore të parashtruesit për shkelje të dispozitave të procedurës penale se gjykata e shkallës së parë e ka shpall fajtor të akuzuarin (parashtruesin) në bazë të deklaratës së tij të dhënë në polici, Gjykata thekson më tej se sipas dispozitave ligjore është përcaktuar se mbrojtja e të pandehurit mund të përdoret si provë (neni 125, paragrafi 2 KPPK-së) në procedurën penale"*.

b) "I akuzuari (parashtruesi i kërkesës) si në polici ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka pohuar faktin se ka qenë në Siri por kategorikisht ka mohuar se kishte pasur për qëllim që t'ju bashkohet organizatave terroriste. Në fakt ky i akuzuar në shqyrtimin gjyqësor thekson ka dëgjuar nga portalet e ndryshme dhe rrjetet sociale për paraqitjen e Lavdrim Muhaxherit dhe e ka ditur se ai ka qenë pjesë e organizatës së Shtetit Islamik të organizatës së "ISIS-it" dhe për këtë arsye ka vendosur për t'iu bashkuar grupit "Ahra Al Sham".

c) "Gjykata vlerëson se matja e dënimeve të shqiptuara ndaj të akuzuarve është bërë në pajtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit konform nenit 73 të KPRK, kështu që dënimet e shqiptuara ndaj tyre janë në përpjesëtim me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer".

26. Parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 518/2016, *"për shkelje të parimit të barazisë midis palëve në procedurë "equality of the arms", sepse gjykata nuk e miratoi propozimin e tij për dëgjimin e dëshmitarëve, duke e shkelur kështu parimin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

27. Më 18 dhjetor 2017, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin, PML. nr. 225/2017, me të cilin e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

"Gjykata vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë në raport me të akuzuarin është i qartë dhe përmban të gjitha të dhënat për kohën, vendin, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe të dhëna të tjera që paraqesin elementet qenësore të veprave të kryera penale. Në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestuese se në kohën kritike, siç është përshkruar në dispoztivin e shkallës së parë, parashtruesi i kërkesës ka qenë në Siri, sikurse edhe fakti se ishte atje për t'u bashkangjitur formacionit terrorist".

28. Sa i përket pretendimit për shkelje të parimit *"barazia e armëve"*, për shkak se Gjykata Themelore nuk e ka aprovuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për t'i dëgjuar zyrtarët e policisë të cilët kishin kryer pyetjen e tij fillestare, Gjykata Supreme theksoi: *"Kjo gjykatë vlerëson, siç ka konkluduar drejt gjykata e shkallës së parë, se nuk është i nevojshëm dëgjimi i tyre meqë dëshmitarët e propozuar, si personat zyrtar (policë) kanë intervistuar të dënuarin në rrethanat e veprës penale, kurse sa i përket pohimit të tij se të njëjtit i është premtuar se ai nuk do të përfshihet në aktakuzë del si i pabazuar sepse siç rezulton nga shkresat e çështjes, ky i dënuar në këtë çështje penale, nuk është shpallur dëshmitar bashkëpunues siç kërkohet me dispozitën e nenit 236 të KPPK, prandaj nuk është shkelur parimi i barazisë së palëve në procedurë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se procedura në tërësi në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe fazën e marrjes në pyetje në polici, kishte shkelur të drejtat e tij kushtetuese, përkatësisht të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, *"sepse edhe me ligj nacional (KPPK) - por edhe me KEDNJ, nxitja e të dyshuarit për të dhënë ndonjë deklaratë "duke i premtuar" apo "duke ushtruar çfarëdo forme të presionit" konsiderohet e pavlefshme"*.

30. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat ia shkelën parimet e prezumimit të pafajësisë dhe barazisë së armëve, pasi që në të gjitha fazat e procedurës ata paragjykuan fajin e tij për veprën e pretenduar penale. Gjykatat përjashtuan parimet kushtetuese se aktakuza duhet të bazohet në dëshmi të arsyeshme dhe të mjaftueshme dhe se barra e të provuarit bie mbi prokurorinë. Rrjedhimisht, ata e privuan parashtruesin nga e drejta e tij për t'u prezumuar i pafajshëm derisa të mos vërtetohet se është fajtor, ndërsa duke refuzuar t'i dëgjonin të vetmit dëshmitarë që ai propozoi, e vendosën atë në një pozitë të pabarabartë në raport me organet që e akuzojnë atë.

31. Parashtruesi i kërkesës konsideron se i është shkelur e drejta në vendim gjyqësor të arsyetuar, sepse vendimet e gjykatave nuk janë logjike, nuk janë në formën e rregullt, nuk janë të qarta në përmbajtje dhe përmbajnë kontradikta.

32. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ndalimi i tij nuk bazohet në një dënim nga një gjykatë kompetente, në shkelje të nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së si rezultat i shkeljes së të drejtës së tij për gjykim të drejtë siç mbrohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

33. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata ta deklarojë kërkesën të pranueshme, të vendosë masë të përkohshme, të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe si rezultat i këtyre shkeljeve erdhi deri te shkelja e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i plotëson kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

36. Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".

37. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe ka parashtruar kërkesë brenda afatit të caktuar.

38. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

39. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

40. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës së pari pretendon se me aktgjykimet e kontestuara i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe si rezultat i këtyre shkeljeve, erdhi deri te shkelja e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së.

41. Gjykata së pari rikujton që, në pajtim me nenin 53. [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

42. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
[...]".

43. Gjithashtu, edhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përcakton:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.
[...]"

44. Gjykata verën se çështja kryesore ka të bëjë me vërtetimin e bazueshmërisë së akuzës penale kundër parashtruesit të kërkesës, prandaj, parashtruesi në procedurën lëndore gëzon garancinë e së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

45. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë. Ai i bazon pretendimet e tij në *i)* faktin se aktgjykimet e kontestuara bazohen në deklaratën e tij të dhënë në procedurën paraprake penale, e cila është shfrytëzuar si dëshmi gjatë gjykimit. Në këtë drejtim, *ii)* parashtruesi i kërkesës pretendon se ishin shkelur të drejtat për mbrojtje sepse e drejta e tij për të heshtur dhe për të mos kontribuar në inkriminimin e tij ishte shkelur, *iii)* për shkak se gjykatat nuk e lejuan atë që në gjykim të thirrë dëshmitarët në mbrojtje të tij, dhe *iv)* sepse aktgjykimet e kontestuara nuk përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe shpjegime për faktet vendimtare. Të gjitha të lartcekurat, sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, qojnë në përfundimin se nuk i janë siguruar garancitë për gjykim të drejtë. Për më tepër, *v)* parashtruesi i kërkesës pretendon se vuajtja e dënimit në bazë të këtyre aktgjykimeve gjyqësore, nuk është e ligjshme, sepse gjykatat kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë, dhe rrjedhimisht vuajtja e dënimit nuk është duke u bërë në bazë të dënimeve të gjykatave kompetente, ashtu si kërkohet me nenin 5(1) të KEDNJ.

46. Gjykata, e udhëhequr nga pretendimet e bëra nga parashtruesi i kërkesës, duke marrë parasysh se ai konsideron se procedura si tërësi nuk ishte e drejtë, rikujton, së pari, në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), sipas të cilës, *"çështja nëse i akuzuari kishte procedurë të drejtë duhet të shikohet në bazë të procedurës në tërësi"* (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Monnel dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Kërkesa nr. 9562/81; 9818/82, të 2 marsit 1987, Seria A, nr. 115, faqe 21, paragrafi 54).

i) Shfrytëzimi i deklaratave të parashtruesit si dëshmi

47. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, *"[...] që aktgjykimet e kontestuara bazohen në prova, përkatësisht në deklaratën e tij [në polici], dhe*

se ka munguar vlerësimi i kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës të provave të tjera", Gjykata së pari rikujton praktikën e vet dhe atë të GJEDNJ-së, sipas së cilës nuk është detyrë e saj të shqyrtojë se si gjykatat e rregullta e kanë vërtetuar gjendjen faktike apo zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, përveç dhe nëse nuk i vë në pikëpyetje të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Prandaj, ajo nuk mund të veprojë si *"gjykatë e shkallës së katërt"* (shih: *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65. Shih, gjithashtu: *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, të 5 prillit 2012).

48. Gjykata vëren se neni 6 i KEDNJ-së garanton të drejtën për një gjykim të drejtë, por nuk vendos rregulla për shfrytëzimin e provave, kjo është kryesisht çështje që rregullohet nga legjislacioni vendor (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Schenk kundër Zvicrës*, Seria A. nr. 140, të 12 korrikut 1988, paragrafët 45-46 dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Teixeira de Castroprotiv kundër Portugalisë,* Raporti 1998-IV, paragrafi 34, të 9 qershorit 1998).

49. Prandaj, si çështje e parimit, Gjykata konsideron se roli i saj nuk është të vërtetojë nëse një lloj i caktuar i provave në gjykatë mund të jetë i pranueshëm ose jo, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës është fajtor apo jo. Në këtë drejtim, pyetja në të cilën duhet përgjigjur është nëse procedura si tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë provat, ishte e drejtë. Kjo përfshin edhe shqyrtimin e "joligjshmërisë" në fjalë, edhe atje ku është në pyetje shkelja e të drejtave të tjera nga KEDNJ (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-s. *Bykov kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 4378/02, paragrafi 89, të 10 marsit 2009, dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Lee Davies kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 18704/05, paragrafi 41, të 28 qershorit 2009).

50. Për më tepër, Gjykata rikujton se nuk do të ndërhyjë në atë se cilat prova të palëve në procedurë gjykatat i dhanë më shumë besim në bazë të shqyrtimit të lirë gjyqësor (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Doorson kundër Hollandës*, Kërkesa 1996/II, paragrafi 78, të 6 marsit 1996).

51. Gjithashtu, GJEDNJ-ja në praktikën e saj tregoi se gjykatat vendore kanë vlerësim të caktuar diskrecional në lidhje me atë se cilat argumente dhe prova do t'i pranojnë në rastin e caktuar, por njëkohësisht kanë obligim ta arsyetojnë vendimin e tyre, duke ofruar arsye të qarta dhe të kuptueshme mbi të cilat e kanë bazuar vendimin (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Suominen kundër Finlandës*, Kërkesa nr. 37801/97, paragrafi 36, të 1 korrikut 2003.).

52. Gjykata vëren se në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë, ndër të tjera, thuhet se njëra nga provat kryesore mbi të cilat u bazua konkludimi për ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të parashtruesit është pikërisht dëshmia që ai e ka dhënë në polici. Në atë deklaratë, parashtruesi ka përshkruar me hollësi veprimet që i ka ndërmarrë në Siri, të cilat gjykatat e rregullta i kanë vlerësuar si elemente qenësorë që padyshim tregojnë ekzistimin e figurës së veprës penale dhe përgjegjësinë e tij penale.

53. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës deklaratën e tij të dhënë në polici e dha në praninë e mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës

zyrtare. Kjo çon në përfundimin se ai gjatë tërë procedurës kishte qasje në asistencë ligjore nga e cila ka mund të përfitoj, si dhe ka mundur të jetë i njoftuar për pasojat që dalin ose mund të dalin nga deklarata e tij në rrjedhën e mëtejshme të procedurës penale.

54. Gjykata më tej vëren se neni 261 i KPP-së përcakton mundësinë që deklaratat e bëra në procedurën e mëparshme mund të përdoren si dëshmi gjatë shqyrtimit gjyqësor.

55. Neni 261 Përdorimi i deklaratave të mëparshme në shqyrtim gjyqësor të KPP-së, thekson:

> *"[...]*
>
> *2. Marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123 paragrafi 2. të këtij Kodi.*
> *3. Deklarata në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123, paragrafi 3. të këtij Kodi".*

56. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë dhënë konkludime të gjëra, duke dhënë arsyet, dhe duke treguar dispozitat relevante ligjore se pse deklarata e parashtruesit të kërkesës në procedurën paraprake është shfrytëzuar si provë. Gjykata nuk konsideron se arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta ishte arbitrar.

ii) **Lidhur me ndalimin e vetëinkriminimit**

57. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për t'u liruar nga vetëfajësimi, sepse deklarata e tij në polici gjatë hetimit ishte shfrytëzuar kundër tij në gjykatë gjatë gjykimit penal.

58. Gjykata rikujton nenin 10 [Njoftimi për shkaqet e akuzës, mosdetyrimi për vetëfajësim dhe ndalesa kundër imponimit për pranim të fajit] të KPP-së, i cili thotë:

> *"1. Gjatë arrestimit të tij dhe marrjes në pyetje për herë të parë, i pandehuri menjëherë njoftohet në hollësi për llojin dhe shkaqet e akuzës kundër tij në gjuhën që ai e kupton.*
>
> *2. I pandehuri nuk ka detyrim të paraqesë mbrojtjen e vet ose të përgjigjet në ndonjë pyetje, dhe nëse mbrohet, nuk është i detyruar të akuzojë vetveten ose të afërmit e tij e as të pranojë fajësinë. Kjo e drejtë nuk përfshin rastin kur i pandehuri hyn vullnetarisht në marrëveshje për të bashkëpunuar me Prokurorin e Shtetit.*
>
> *3. Nga i pandehuri ose personi tjetër që merr pjesë në procedurë ndalohet dhe dënohet që të imponohet pranimi i fajësisë ose ndonjë deklarim tjetër me anë të torturës, forcës, kanosjes apo nën ndikimin e drogës ose të masave të tjera të ngjashme".*

59. Gjykata gjithashtu rikujton se e drejta për një gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, siguron disa garanci minimale për çdo person të akuzuar për një vepër penale, e cila përfshin të drejtën e lirisë nga vetëfajësimi, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (shih Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 19187/91, paragrafët 68 dhe 69, të 17 dhjetorit 1996, si dhe GJEDNJ *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa 18731/91, paragrafi 45, i 8 shkurtit 1996).

60. Në këtë drejtim, e drejta e personit për të mos fajësuar veten, nënkupton që në procedurën penale kërkohet nga prokurori të provojë çështjen e tij kundër të akuzuarit pa përdorur dëshmi të fituara nëpërmjet metodës së dhunës dhe represionit në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit. E drejta për mos ta inkriminuar veten është kryesisht e lidhur me vullnetin e palës së akuzuar për t'u mos deklaruar, përkatësisht të drejtën në heshtje që zbatohet edhe në rastin e marrjes në pyetje të të dyshuarit (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa 19187/91, paragrafët 68 dhe 69, të 17 dhjetorit 1996, si dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa 18731/91, paragrafi 45, të 8 shkurtit 1996).

61. Përfundimisht, e drejta në heshtje nuk është absolute, dhe në vlerësimin nëse procedura ka shkele vetë thelbin e garancive kundër vetëfajësimit, GJEDNJ-ja i vlerëson në bazë të: a) *natyrës dhe shkallës së dhunës*, b) *ekzistimit të ndonjë mase mbrojtëse relevante*, dhe c) *përdorimin e provës të fituar në këtë mënyrë.* (shih GJEDNJ, *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa 18731/91, paragrafi 45, i 8 shkurtit 1996).

62. Më tej, Gjykata do ta elaboroj pretendimin e parashtruesit të kërkesës, se i është *"shkelur e drejta për mbrojtje dhe garancitë në lidhje me mbrojtjen nga vetë inkriminimi, për shkak se deklarata e tij është përdorur si dëshmi"*.

63. Lidhur me këtë, Gjykata së pari thekson se gjatë vlerësimit nëse procedura ishte e drejtë në tërësi, duhet pasur parasysh nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës kishte mundësi ta kontestoj ligjshmërinë e provave dhe të kundërshtoj përdorimin e tyre (shih, Aktgjykimin e GEDNJ-së, *Szilagyi kundër Rumanisë*, Kërkesa 30164/04, të 17 dhjetorit 2013).

64. Përveç kësaj, duhet të merret parasysh edhe cilësia e provës, duke përfshirë nëse rrethanat në të cilat është marrë tregojnë dyshimin për besueshmërinë ose saktësinë e saj (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Lisica kundër Kroacisë*, Kërkesa 20100/06, paragrafi 49, të 25 shkurtit 2010).

65. Për më tepër, problemi i drejtësisë nuk do të paraqitet domosdoshmërisht kur dëshmia e marrë nuk mbështetet nga materiale të tjera. Rrjedhimisht duhet pasur parasysh se kur prova është shumë e fortë dhe është e pranueshme pa ndonjë dyshim, nevoja për prova të tjera të cilat e mbështesin atë zvoglohet (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Davies kundër Belgjikës*, Kërkesa 18704/05 paragrafi 42, të 28 qershorit 2009, si dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Bykov kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 4378/02, paragrafi 90, të 10 marsit 2009).

66. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë konkluduar, duke dhënë arsye të mjaftueshme dhe arsyetimet që edhe kjo Gjykatë nuk i konsideron arbitrare, që deklarata e parashtruesit e dhënë në polici është marrë në mënyrë ligjore. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës para se të jepte dëshminë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije në praninë e mbrojtësit të tij, hoqi dorë nga e drejta për të mos iu përgjigjur pyetjeve të zyrtarëve kompetentë përgjegjës për hetimin dhe të mos ta shfrytëzoj të drejtën e tij të qëndrojë i heshtur.

67. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në asnjë fazë të procedurës në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit apo Gjykatën Supreme, nuk dëshmonte se ai në polici ishte i ekspozuar ndonjë lloji të presionit për faktin se ishte në paraburgim policor. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu nuk kishte vërejtje ndaj emërimit të mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare, dhe në këtë kuptim "*kishte masa mbrojtëse*" në kuptimin e parimeve të mësipërme.

68. Gjithashtu, nga faktet e rastit rrjedh se parashtruesi i kërkesës para deklaratës të dhënë në polici, ishte konsultuar me mbrojtësin e tij pa praninë e personave të tjerë, për më tepër, parashtruesi gjithashtu gjatë dhënies së dëshmisë në Gjykatën Themelore kishte kohë të mjaftueshme që në konsultim me mbrojtësin e tij ta përgatit mbrojtjen e tij me të cilën do ta kontestonte deklaratën e dhënë më herët në polici, prej nga rrjedh konkludimi se parashtruesit nuk i është mohuar mundësia për të kundërshtuar përdorimin e deklaratës së tij si provë.

69. Së fundi, siç vuri në dukje Gjykata Themelore, me analizën e kujdesshme të deklaratës së bërë nga parashtruesi i kërkesës në polici dhe deklaratës që ai dha në mbrojtjen e tij në Gjykatën Themelore, u konstatua se ato ndryshonin mjaftueshëm që gjykata të vërteton se ato ndryshonin në masën e mjaftueshme që të vërtetojnë faktin se parashtruesi është i vetëdijshëm për veprën penale dhe se ka vendosur të mbrohet, por që "*[...] Gjykata nuk i fali besimin të akuzuarit Albert Berisha e as tezës mbrojtëse të avokates se tij, të paraqitur në Gjykatën Themelore...*".

70. Në bazë të të gjithave që u thanë më sipër, Gjykata konstaton si të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljet e pretenduara të drejtës për mbrojtje dhe garancitë në lidhje me mbrojtjen kundër vetëinkriminimit.

iii) **Lidhur me mohimin për të dëgjuar dëshmitarët e mbrojtjes**

71. Më tej, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës "*se i është shkelur parimi i barazisë së palëve në procedurën gjyqësore, sepse gjykatat nuk donin të pranonin dëshmitarët që ai i rekomandoi[...]*", Gjykata i konstaton si të pabazuara, pasi që parashtruesi i kërkesës të njëjtat argumente i bëri në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, në të cilat mori përgjigje të hollësishme ndaj pretendimeve të tij, për të cilat gjykatat siguruan bazë ligjore.

72. Gjykata nuk mund të mos vërejë se Gjykata Supreme në Aktgjykimin PML. nr. 225/2017, në mënyrë konkrete iu përgjigj parashtruesit dhe pse Gjykata Themelore në Aktgjykimin PKR. nr. 263/15, refuzoi kërkesën për të dëgjuar dy zyrtarë të PK-së, të cilët gjatë procedurës hetimore kishin marrë në pyetje

parashtruesin në praninë e mbrojtësit, duke theksuar *"[...] se nuk është i nevojshëm dëgjimi i tyre meqë dëshmitarët e propozuar, si personat zyrtar (policë) kanë intervistuar të dënuarin në rrethanat e veprës penale, kurse sa i përket pohimit të tij se të njëjtit i është premtuar se ai nuk do të përfshihet në aktakuzë del si i pabazuar..."*.

iv) **Lidhur me vendimin e arsyetuar**

73. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë *"[...] sepse aktgjykimet e gjykatave nuk janë logjike, në formën e rregullt, nuk janë të qarta në përmbajtje dhe kanë kontradikta dhe kundërthënie"*, Gjykata thekson se, sipas praktikës së përcaktuar të GJEDNJ-së, neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat të, *intera alia,* arsyetojnë aktgjykimet e tyre. Ky detyrim, megjithatë, nuk mund të kuptohet si detyrim që në aktgjykim të paraqiten të gjitha detajet dhe të jepen përgjigje të gjitha pyetjeve dhe argumenteve të paraqitura (shih: Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Ruiz Torio kundër Spanjës*, të 9 dhjetorit 1994, Seria A, nr. 303-A, paragrafi 29, shih, Vendimin e GJEDNJ-së, *Harutyunyan kundër Armenisë*, të 5 korrikut 2005, Kërkesa nr. 36549/03).

74. Gjykata vëren se, qëndrimi i marrë nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, *vendimet përfundimtare të gjykatave të apelit nuk duhet të kenë arsyetime të hollësishme, por ato që gjykata i konsideron relevante dhe të bazuara* (shih: Vendimin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, 8769/07, të 16 korrikut 1981, OI 25).

75. Në thelb, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përpiqet të justifikojë shkeljen e supozuar, me qëndrimin se *" [...] Gjykata nuk bën një lidhje logjike mes kornizës ligjore dhe gjendjes faktike. Gjykatat në vend që të arsyetojnë substancën e vendimit të tyre, ato parashtrojnë pyetje hipotetike - të cilat janë jorelevante për një vendim gjyqësor"*.

76. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës edhe në Gjykatën Supreme, kryesisht i përsëriti të njëjtat pretendime ankimore, për të cilat gjykata në Aktgjykimin PML. nr. 225/2017, u përgjigj, duke theksuar *"Gjykata vlerëson se dispozitivat e aktgjykimit të shkallës së parë në raport me të akuzuarin janë të qarta dhe përmbajnë të gjitha të dhënat për kohën, vendin, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe të dhëna të tjera që paraqesin elementet qenësore të veprave të kryera penale. Në arsyetimin e të dy aktgjykimeve janë dhëne arsye ligjore për të gjitha pikat e aktgjykimit"*.

77. Gjykata këto pretendime të parashtruesit të kërkesës i gjen si të pabazuara dhe ligjërisht të pajustifikuara. Kjo, sepse Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit në aktgjykimet kanë dhënë arsyetime të qarta për vendimet e tyre, si në lidhje me gjendjen e vërtetuar faktike ashtu edhe për zbatimin e të drejtës materiale, dhe të cilat kjo Gjykatë nuk i konsideron arbitrare.

78. Për arsyet e parashtruara më lart, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

v) **Lidhur me të drejtën për liri dhe siguri**

79. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se, për shkak se atij nuk i është siguruar një gjykim i drejtë, paraburgimi i tij nuk bazohet në "dënim nga një gjykatë kompetente" siç kërkohet me nenin 5 të KEDNJ-së. Parashtruesi pretendoi se ai është dënuar me aktgjykimet të cilat janë jokushtetuese, që është arsyeja pse dënimi i tij me burgim është gjithashtu jokushtetues.

80. Së pari, Gjykata rikujton që GJEDNJ thotë se neni 5 paragrafi (1) pika (a) e KEDNJ-së lejon heqjen e lirisë *"pas dënimit nga një gjykatë kompetente"*. GJEDNJ thotë se fjala "pas" nuk do të thotë thjesht se 'burgimi' duhet të ndjekë "dënimin" në të njëjtin kohë: përveç kësaj, 'burgimi' duhet të rezultojë nga, 'të ndjekë dhe të varet' ose të ndodhë në bazë të 'dënimit'. " (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *B. kundër Austrisë*, Kërkesa 11968/86, të 28 marsit 1990, paragrafi 38).

81. Gjykata konstaton se, sipas kornizës legjislative të Kosovës, procedurat që çuan në një dënim penal ndaj parashtruesit të kërkesës janë zhvilluar nga gjykatat e themeluara në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme në Kosovë. Për më tepër, nuk ka asgjë në procedurat e aplikuara nga gjykatat e rregullta për të vënë në dyshim "kompetencën" e tyre sipas ligjit ose Kushtetutës.

82. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është dënuar nga një "*gjykatë* kompetente" e cila ka kryer një procedurë gjithëpërfshirëse që ka rezultuar në përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe *"nxjerrjen e një aktgjykimi të formës së prerë"*, që e ka dënuar parashtruesin e kërkesës me burgim (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *B. kundër Austrisë*, kërkesa nr. 11968/86 e 28 marsit 1990).

83. Gjykata konkludon se dënimi i parashtruesit nga një gjykatë kompetente ishte krejtësisht i mjaftueshëm për të justifikuar ndalimin e tij në përputhje me kërkesat e nenit 5 të KEDNJ-së dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 5 të KEDNJ-së duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

Përfundim

84. Duke pasur parasysh të gjitha që u thanë më sipër, duke përfshirë rrethanat e rastit, dhe arsyetimin e dhënë në vendimet e kontestuara, Gjykata nuk sheh asnjë arbitraritet në zbatimin e të drejtës materiale në gjykimin penal të parashtruesit të kërkesës. Gjykata gjithashtu, nuk gjen asnjë element që do të tregonte parregullsi ose arbitraritet në marrjen e vendimeve të kontestuara në dëm të parashtruesit.

85. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon që procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se thelbi i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm është shkelur ose që

parashtruesi është privuar nga çdo lloj garancie procedurale, gjë që do të çonte në shkelje së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës ose paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

86. Gjykata konsideron se është obligim i parashtruesit të kërkesës që t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe t'i paraqesë provat *prima facie* që tregojnë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në pajtim me juridiksionin e Gjykatës (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, të 5 dhjetorit 2013).

87. Megjithatë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe nuk ka treguar se të drejtat e tij ishin shkelur.

88. Gjykata më tej konsideron se nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt".

89. Në përfundim, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe të drejtën për liri dhe siguri të garantuar me nenin 5 të KEDNJ-së, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

90. Prandaj, kërkesa e parashtruesit, në tërësi, është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

Kërkesë për masë të përkohshme

91. Gjykata rikujton që parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme "*sepse konsideron se po privohet padrejtësisht nga liria, si rezultat i nxjerrjes së vendimeve gjyqësore kundërkushtetuese*".

92. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, i cili përcakton:

> *1."Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".*

93. Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:*
>
> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
> *(...)*

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

94. Gjykata përsërit konkludimin se kërkesa e parashtruesit është shpallur e papranueshme, si qartazi e pabazuar, pasi që parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës.

95. Prandaj, në pajtim me nenin 116.2 të Kushtetutës, nenit 27.1 të Ligjit dhe rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (1 dhe 7) të Kushtetutës, nenet 27.1 dhe 47.2 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d), 55 (4) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 maj 2018,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Arta Rama-Hajrizi